

« INTER-GAZ » sh.a.

Pasqyrat Financiare më dhe
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

PËRMBAJTJA:

	FAQE
PASQYRAT FINANCIARE:	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	2
PASQYRA E PERFORMANCËS	3
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	4
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE	5
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE	6 - 21

INTER-GAZ sh.a.

Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015

(Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e Pozicionit Financiar
më 31 dhjetor 2015

	Shënime	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
AKTIVET			
Aktive afatshkurtra			
Mjete monetare	4	252,122	156,261
Llogari të arkëtueshme tregtare	5	104,822,140	75,730,600
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	6	60,324,698	5,095,346
Të tjera llogari të arkëtueshme	7	20,047,186	27,115,204
Inventari	8	166,916	
Total Aktive Afatshkurtra		185,613,062	108,097,411
Aktivët afatgjatë			
Aktive afatgjatë materiale	9	720,154,939	731,112,978
Aktive afatgjatë jomateriale	9	28,220,140	28,589,032
Total aktive afatgjatë		748,375,079	759,702,010
Total aktive		933,988,141	867,799,421
DETYRIMET			
Detyrime afatshkurtra			
Hua afatshkurtra	10	9,958	131,252,667
Llogari të pagueshme tregtare	11	13,906,035	33,388,114
Llogari të pagueshme nga palët e lidhura	12	2,755,663	16,818,873
Detyrime të konstatuara	13	11,000	77,050,501
Detyrime tatimore	14	1,933,376	1,656,133
Provizione	15	7,365,834	
Të tjera detyrime	16	1,021,349	
Total Detyrime afatshkurtra		27,003,215	260,166,288
Detyrime afatgjatë			
Hua afatgjatë	17	-	50,038,754
Llogari të pagueshme nga palët e lidhura	18	931,752,176	615,543,181
Total detyrime afatgjatë		931,752,176	665,581,935
Totali i detyrimeve		958,755,391	925,748,223
KAPITALI			
Kapitali aksionar	19	2,000,000	2,000,000
Rezerva të tjera		2,067,562	2,067,562
Fitime të mbartura		(62,016,364)	(52,222,311)
Fitimi i ushtrimit		33,181,552	(9,794,053)
Total kapitali		(24,767,250)	(57,948,802)
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		933,988,141	867,799,421

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 21, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

INTER- GAZ sh.a.

Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015

(Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e Performancës

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	20	81,426,785	60,324,332
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	20	(1,420,250)	9,797,692
Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme		(5,741,640)	(15,829,471)
Lënda e parë dhe materiale të			
1) konsumueshme	21	(1,964,233)	(681,646)
2) Të tjera shpenzime	22	(3,777,407)	(15,147,825)
Shpenzime të personelit		(16,133,601)	(14,517,918)
1) Paga dhe shpërblime	23	(13,915,671)	(12,523,629)
Shpenzime të sigurimeve			
2) shoqërore/shëndetësore	23	(2,217,930)	(1,994,289)
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	9	(10,668,690)	(10,868,940)
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit	24	(7,365,834)	(14,485,291)
Shpenzime financiare		530,803	(23,386,592)
Shpenzime interesi dhe shpenzime të			
1) ngjashme	23	39,639,344	(23,386,592)
2) Shpenzime të tjera financiare	23	(39,108,541)	
Fitimi/humbja para tatimit		40,627,573	(8,966,188)
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin		(7,446,021)	(827,865)
1) Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin		(7,446,021)	(827,865)
Fitimi/humbja e vitit		33,181,552	(9,794,053)
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin:		-	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin		33,181,552	(9,794,053)

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 21, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

INTER- GAZ sh.a.
Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015
(Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e ndryshimeve në Kapital
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

	Kapitali aksionar	Rezerva të tjera	Fitim / Humbja e vitit	Totali
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2013	2,000,000	2,067,562	(52,222,311)	(48,154,749)
Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin:				
Pozicioni financiar i rideklaruar më 31 dhjetor 2014	2,000,000	2,067,562	(62,016,364)	(57,948,802)
Totali i të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin:				
Fitimi / Humbja e vitit			33,181,552	33,181,552
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse:				
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2015	2,000,000	2,067,562	(28,834,812)	(24,767,250)

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 18, të cilat janë pjesë përfundimtare e kësaj pasqyre financiare.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 janë aprovuar nga administratori i INTER-GAZ sh.a. më 26/03/2016 dhe janë firmosur si më poshtë.

Arbëre Xheqiri
Administrator i Falimentit



[Signature]
Studio Kontabel



INTER-GAZ sh.a.

Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015

(Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014
Flukset e parasë nga aktivitetet operative		
Fitim / Humbja e vitit	40,627,573	(8,966,188)
Rregullimet për shpenzimet jomonetare:		
Shpenzimet financiare jomonetare	(39,644,461)	
Shpenzimet për tatimin mbi fitimin jomonetar	(7,446,021)	(827,865)
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	10,668,690	10,868,940
Humbja nga shitja e aktiveve financiare	1,420,250	
Ndrryshimet në aktivet dhe detyrimet e shfrytëzimit:		
Rënie/(rritje) në të drejtat	(77,252,872)	(51,783,301)
Rënie/(rritje) në inventarë	(166,916)	398,295
Rritje/(rënie) në detyrimet	(24,880,863)	(102,071,493)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit	(96,674,620)	(152,381,612)
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit		
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale	(3,883,811)	(398,986)
Arkëtime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale	3,121,800	
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit	(762,011)	(398,986)
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit		
Hua të arkëtuara/paguara	134,927,532	129,351,074
Interes i paguar	(37,395,040)	23,386,592
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit	97,532,492	152,737,666
Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare	95,861	(42,932)
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar	156,261	199,193
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor	252,122	156,261
4		

Pasqyra e fluksit të parasë duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 21, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

INTER-GAZ sh.a.

Shënime shoqëruese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015

(Vlerat janë në Lek)

1. TË PËRGJITHSHME

Shoqëria "INTER-GAZ " Sha është krijuar në vitin 2002., me vendim gjykatë Nr.27561 Datë 11.04.2002. Veprimtaria e saj rregullohet nga statuti i saj.

Ortakët e kompanisë janë z. PIRO BARE dhe ARTAN DULAKU të cilët zoterojnë në mënyrë të barabartë 50% të kuotave të kapitalit të shoqërisë. Administrator i shoqërisë është Frederik Bare.

Sella e shoqërisë është: 700 MI në veri të Hidrovorit, Porto-Romano, Durres. Ajo është regjistruar pranë organeve tatimore të rrethit Durres me NIPT K21916802B.

Aktiviteti kryesor i kësaj shoqërie është dhënia me qera e depozitave të gazit dhe ambjentëve të saj.

Më 31 Dhjetor 2015 Shoqëria kishte 15 punonjës.

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1 Deklarata e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr.9228, datë 29 prill 2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

Në bazë të urdhrit nr. 64 datë 22.7.2014 "Për shpalljen e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre", Ministria e financave vendosi të bëjë të detyrueshme zbatimin e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara duke filluar nga 1 janar 2015.

Ky urdhër hyri në fuqi me fletoren zyrtare nr.119, datë 1 gusht 2014.

2.2 Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3 Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4 Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5 Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)

2.5.1 Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuar të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.5.2 Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50%, në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

2.6 Krahasueshmëria e informacionit

Siç paraqitet në Standardin Kombëtar të Kontabilitetit të përmirësuar nr.1, në rastet e një ndryshimi në paraqitjen e pasqyrave financiare si pasojë e kërkesave të një standardi të ri, një përmirësimi në standard apo një ndryshimi në ligjin për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare, informacioni krahasues duhet të riparaqitet për të korresponduar me paraqitjen e re, përveç rasteve kur riparaqitja e informacionit krahasues nuk mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

Informacioni krahasues për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014 është riparaqitur për të korresponduar me paraqitjen e re të pasqyrave financiare siç kërkohet nga Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuar.

3. Politikat kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivët dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisht të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursit i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 Dhjetor 2015 dhe 2014 është detajuar si më poshtë:

	31 Dhjetor 2015	31 Dhjetor 2014
Kurset e këmbimit		
Euro/Lek	137.28	140.14
Usd/Lek	125.79	115.23

3. Politikat kontabël

3.2 Instrumenta financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

3. Politikat kontabël (vazhdim)

3.2 Instrumenta financiare (vazhdim)

Kapitali aksionar

Kapitali aksionar njihet me vlerën nominale. Aksionet e zakonshme klasifikohen si kapitale.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivitet financiar të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivitet të tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivitet financiar të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.3 Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

3.4 Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivitet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitet. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitet në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe koston e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivitet. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivitet kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivitet afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

3. Politikat kontabël (vazhdim)**3.4 Aktive afatgjata materiale (vazhdim)***iii. Amortizimi*

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin aktual është si më poshtë:

Kategoria e AQT-ve	Norma e Amortiz në %	Norma e Amortiz në %	Metoda
	2015	2014	
Toka	0	0	
Ndërtime e instalime	2	2	
Makineri e Pajisje	1	1	Mbi vlerën e mbetur të AQT-ve
Mjete transporti	1	1	
Pajisje zyre	10	10	
Pajisje kompjuterike	10	10	
Aktive jo materiale	1	1	Metoda lineare

Llogaritja e amortizimit për AQT e hyra gjatë vitit bëhet duke filluar nga data 1 e muajit pasardhës. Kompania ka llogaritur amortizimin për të gjitha grupet e aktiveve.

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3.5 Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundur që njësia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

3.6 Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3.7 Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

Shoqëria ka vetëm qira operative.

3. Politikat kontabël (vazhdim)

3.8. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.9. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2015 është 15% (2014: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshem (apo të rikuperueshem) në periudhat e ardhshme, i cili përlllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

Aktivitet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundur që fitimi i tatueshem në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

3.10. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në Juridiksionin përkatës sipas një plani kontributesh pensioni të përcaktuar.

3.11. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

3.12. Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

INTER-GAZ sh.a.

Shënime shoqëruese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015

(Vlerat janë në Lek)

3.13. Aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

4. MJETE MONETARE

Teprica e likuiditeteve për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2015 dhe atë që mbyllet më 31 Dhjetor 2014 paraqitet si më poshtë:

	31 Dhjetor 2015 ne Lek	31 Dhjetor 2014 ne Lek
Mjete monetare ne banke	104,950	91,810
Mjete monetare ne arke	147,172	64,451
	<u>252,122</u>	<u>156,261</u>

5. LLOGARI TË ARKËTUESHME

Llogaritë e arkëtueshme përfaqësojnë detyrime të pa arkëtuara nga klientët në datën e mbylljes së Pasqyrave Financiare. Llogaritë e arkëtueshme më 31 Dhjetor 2015 dhe 2014 janë si më poshtë:

	31 Dhjetor 2015 ne Lek	31 Dhjetor 2014 ne Lek
Kliente per fatura te leshuara	104,822,140	75,730,600
Kliente per tu faturuar	-	-
	<u>104,822,140</u>	<u>75,730,600</u>

6. LLOGARI TË TJERA TË ARKËTUESHME NGA PALET E LIDHURA

Llogaritë e arkëtueshme nga palët e lidhura përfaqësojnë detyrime të pa arkëtuara nga palët e lidhura në datën e mbylljes së Pasqyrave Financiare.

Llogaritë e arkëtueshme më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 janë si më poshtë:

	31 Dhjetor 2015 ne Lek	31 Dhjetor 2014 ne Lek
Llogari te arketueshme tregtare nga palet e lidhura	4,460,706	5,095,346
Llogari te tjera te arketueshme nga ortakët	823,680	-
Llogari te tjera te arketueshme nga shoqëri te lidhura	55,040,312	-
	<u>60,324,698</u>	<u>5,095,346</u>

INTER-GAZ sh.a.

Shënime shoqëruese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015

(Vlerat janë në Lek)

7. TE TJERA LLOGARI TE ARKETUESHME

Në llogaritë tjera të arkëtueshme janë paraqitur të tjera të drejta si me poshtë:

	31 Dhjetor 2015 në Lek	31 Dhjetor 2014 në Lek
Te tjera tatime për tu paguar dhe për tu kthyer	20,047,186	20,047,186
Tatim fitimi i parapaguar	-	7,065,428
Te tjera		2,590
	20,047,186	27,115,204

Shuma prej 20,047,186 Lek paraqet gjatë vitit të cilat gjykata e shkallës së parë ka vendosur si të padrejta nga kontrolli tatimor.

8. INVENTARI

Inventari më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 janë si më poshtë :

	31 Dhjetor 2015 në Lek	31 Dhjetor 2014 në Lek
Mallra	166,916	-
	166,916	-

9. AKTIVE AFATGJATA MATERIALE

Lëvizjet e Aktiveve Afatgjata Materiale dhe Jomateriale gjatë vitit ushtrimit janë pasqyruar më poshtë:

	Makinëri dhe pajisje		Automjete	Të tjera	Parapajime	TOTAL AAM	AAM	Totali
	Ndërtesa							
Kosto								
Gjendja më 31 Dhjetor 2013	324,071,578	868,111,835	20,188,773	3,252,294		1,215,624,480	36,889,075	1,252,513,555
Shtesa		148,833		250,153		398,986		398,986
Nxjerrje jashtë përdorimit								
Gjendja më 31 Dhjetor 2014	324,071,578	868,260,668	20,188,773	3,502,447	-	1,216,023,466	36,889,075	1,252,912,541
Shtesa	75,000	1,572,803		4,168	2,231,840	3,883,811		3,883,811
Nxjerrje jashtë përdorimit		(198,208)	(9,931,625)			(10,129,833)		(10,129,833)
Gjendja më 31 Dhjetor 2015	324,146,578	869,635,263	10,257,148	3,506,615	2,231,840	1,209,777,444	36,889,075	1,246,666,519
Zhvlerësimi i akumuluar								
Gjendja më 31 Dhjetor 2013	25,288,709	435,579,787	11,632,687	1,909,256		474,410,439	7,931,152	482,341,591
Amortizimi i vitit	5,943,842	4,326,145	85,561	144,501		10,500,049	368,891	10,868,940
Nxjerrje jashtë përdorimit								
Gjendja më 31 Dhjetor 2014	31,232,551	439,905,932	11,718,248	2,053,757	-	484,910,488	8,300,043	493,210,531
Amortizimi i vitit	5,826,007	4,291,307	111,046	71,439		10,299,799	368,891	10,668,690
Nxjerrje jashtë përdorimit		(75,031)	(5,512,751)			(5,587,782)		(5,587,782)
Gjendja më 31 Dhjetor 2015	37,058,558	444,122,208	6,316,543	2,125,196	-	489,622,505	8,668,934	498,291,439
Vlera neto kontabël								
Gjendja më 31 Dhjetor 2013	298,782,869	432,532,048	8,556,086	1,343,038	-	741,214,041	28,957,923	770,171,964
Gjendja më 31 Dhjetor 2014	292,839,027	428,354,736	8,470,525	1,448,690	-	731,112,978	28,589,032	759,702,010
Gjendja më 31 Dhjetor 2015	287,088,020	425,513,055	3,940,605	1,381,419	2,231,840	720,154,939	28,220,141	748,375,080

NTËR-GAZ sh.a.

Shënime shoqëruese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015

(Vlerat janë në Lek)

10. HUA AFATSHKURTER

Në këtë zë janë paraqitur huatë afatshkurtra (overdrafte) të marra nga bankat e nivelit të dytë. Më poshtë janë paraqitur këto hua sipas bankave më 31 dhjetor 2015 dhe 2014:

	31 Dhjetor 2015 ne Lek	31 Dhjetor 2014 ne Lek
Hua fatshkurtra (Overdrafte)	9,958	131,252,667
	<u>9,958</u>	<u>131,252,667</u>

11. LLOGARI TË PAGUESHME TREGTARE

Në këtë zë janë paraqitur detyrimet e palikujduara ndaj furnitorëve. Më poshtë janë paraqitur këto detyrime më 31 Dhjetor 2015 dhe 2014:

	31 Dhjetor 2015 ne Lek	31 Dhjetor 2014 ne Lek
Te pagueshme ndaj furnitoreve	13,906,035	33,388,114
	<u>13,906,035</u>	<u>33,388,114</u>

12. LLOGARI TË PAGUESHME TREGTARE NDAJ PALEVE TE LIDHURA

Te pagueshme ndaj paleve te lidhura më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 paraqiten si më poshtë:

	31 Dhjetor 2015 ne Lek	31 Dhjetor 2014 ne Lek
Llogari te pagueshme tregtare ndaj paleve te lidhura	2,755,663	16,818,873
	<u>2,755,663</u>	<u>16,818,873</u>

13. TE PAGUESHME PER SHPENZIME TE KONSTATUARA

Te pagueshme per shpenzime te konstatuara më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 paraqiten si më poshtë:

	31 Dhjetor 2015 ne Lek	31 Dhjetor 2014 ne Lek
Interesa pasive te llogaritura	-	77,037,900
Te tjera detyrime te konstatuara	11,000	12,601
	<u>11,000</u>	<u>77,050,501</u>

INTER-GAZ sh.a.

Shënime shoqëruese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015

(Vlerat janë në Lek)

14. DETYRIME TATIMORE

Teprica e detyrimeve ndaj shtetit analizohet si më poshtë për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2015 dhe atë që mbyllet më 31 Dhjetor 2014 paraqitet si më poshtë:

	31 Dhjetor 2015 ne Lek	31 Dhjetor 2014 ne Lek
Sigurime Shoqerore dhe shendetesore	263,148	343,201
Tatim mbi te ardhurat personale	67,481	76,956
Tatim mbi fitimin	380,593	-
Shteti-TVSh per tu paguar	1,222,154	1,235,976
	1,933,376	1,656,133

15. PROVIZIONET

Provizionet më 31 Dhjetor 2015 dhe 2014 paraqiten si më poshtë :

	31 Dhjetor 2015 ne Lek	31 Dhjetor 2014 ne Lek
Gjendje ne fillim	-	-
Shtesa provizione per penalitete	7,365,834	-
Teprica per vitin	7,365,834	-

Gjate vitit shoqeria ka krijuar nje provizion per penalitete ne baze te kerkesave nga ana e organeve tatimore qe kane kerkuar hapjen e procedures se falimentit te shoqerise per detyrimin e mesiperm. Pagesa e gjobave eshte kusht per aprovimin e e planit te riorganizimit te shoqerise dhe perfundimit te procedures se falimentit. Shoqeria ka hapur padi per penalitetet e mesiperme dhe procesi gjyqesor eshte i pezulluar nga gjykata.

16. DETYRIME TE TJERA

Detyrimet te tjera më 31 Dhjetor 2015 dhe 2014 paraqiten si më poshtë:

	31 Dhjetor 2015 ne Lek	31 Dhjetor 2014 ne Lek
Detyrime ndaj punonjesve	1,021,349	-
	1,021,349	-

17. DETYRIME AFATGJATA

Në këtë janë paraqitur dhe detyrimet afatgjata të shoqerisë për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2015 dhe atë që mbyllet më 31 Dhjetor 2014 :

	31 Dhjetor 2015 ne Lek	31 Dhjetor 2014 ne Lek
Hua nga pale te treat	-	50,038,754
	-	50,038,754

INTER-GAZ sh.a.

Shënime shoqëruese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015

(Vlerat janë në Lek)

18. LLOGARI TE PAGUESHME AFATGJATE NGA PALET E LIDHURA

Ne këtë zë është paraqitur detyrimi që ka shoqëria ndaj ortakëve të shoqërisë dhe shoqerive të tjera të lidhura për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2015 dhe atë që mbyllet më 31 Dhjetor 2014 :

	31 Dhjetor 2015 ne Lek	31 Dhjetor 2014 ne Lek
Hua nga ortakët	564,006,388	536,830,861
Hua nga shoqëri të lidhura	367,745,788	78,712,320
	931,752,176	615,543,181

19. KAPITALI AKSIONAR

Kapitali aksionar i Shoqërisë është në vlerë 2,000,000 Leke (2014: 2,000,000).

	31 Dhjetor 2015		31 Dhjetor 2014	
	Numri i aksioneve	% e kapitalit aksionar	Numri i aksioneve	% e kapitalit aksionar
Piro Bare	1,000	50%	1,000	50%
Artan Dulaku	1,000	50%	1,000	50%
	2,000	100%	2,000	100%
Vlera nominale per aksion	1,000		1,000	
Vlera e kapitalit aksionar	2,000,000		2,000,000	

20. TË ARDHURA NGA AKTIVITETI I SHFRYTEZIMIT

Të ardhurat nga veprimtaria e zakonshme për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 janë si më poshtë:

	31 Dhjetor 2015 ne Lek	31 Dhjetor 2014 ne Lek
Te ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	81,426,785	60,324,332
Fitim/Humbja nga shitja e AAM-ve	(1,420,250)	-
Te ardhura të tjera	-	9,797,692
	80,006,535	70,122,024

INTER-GAZ sh.a.

Shënime shoqëruese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015

(Vlerat janë në Lek)

	31 Dhjetor 2015 ne Lek	31 Dhjetor 2014 ne Lek
<i>Flitim/Humbja nga shitja e AAM-ve</i>		
Te ardhura nga shitja e AAM-ve	3,121,800	-
Vlera kontabel neto e AAM-ve të shitura	(4,542,050)	-
	(1,420,250)	-

Tabela me poshte paraqet rakordimin e te ardhurave per shifren e afarizmit:

	31 Dhjetor 2015 ne Lek
<i>Rakordimi i te ardhurave me FDP-ne</i>	
Qarkullim i tatueshem	84,548,585
Zbriten vlera kontabel neto e aktiveve te shitura perfshire ne te ardhura te tjera	(4,542,050)
Shuma e qarkullimit e korrektuar	80,006,535
Sipas Kontabilitetit	80,006,535
Diferenca	-

21. LENDA E PARE DHE MATERIALE TE KONSUMUESHME

Kosto e materialeve te para dhe te tjera te konsumueshme per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2015 dhe ate te mbyllur me 31 Dhjetor 2014 paraqitet si me poshte:

	31 Dhjetor 2015 ne Lek	31 Dhjetor 2014 ne Lek
Shpenzime material	1,964,233	681,646
	1,964,233	681,646

22. SHPENZIME TË TJERA

Këto shpenzime janë analizuar në tabelën e mëposhtme:

	31 Dhjetor 2015 ne Lek	31 Dhjetor 2014 ne Lek
Mirembajtje dhe riparime	817,181	811,960
Sigurime	295,390	56,140
Shpenzime postare dhe telekomunikimi	137,998	148,313
Shpenzime per sherbime bankare	105,212	26,445
Te tjera tatime e taksa	889,829	856,500
Blerje energji; avull; uje	91,800	2,000
Shpenzime te tjera te pazbritshme	154,894	-
Shpenzime te ndryshme	1,285,103	13,246,467
	3,777,407	15,147,825

INTER-GAZ sh.a.

Shënime shoqëruese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015

(Vlerat janë në Lek)

23. SHPENZIMET E PERSONELIT

Shpenzimet e personelit për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015 dhe 2014 janë si më poshtë:

	31 Dhjetor 2015 në Lek	31 Dhjetor 2014 në Lek
Shpenzime për paga dhe shpërblime	13,815,671	12,523,628
Shpenzime për sigurime shpërore e shëndetsore	2,217,930	1,994,290
Shpenzime të tjera për personelin	100,000	-
	16,133,601	14,517,918

24. SHPENZIME TË TJERA TË SHFRYTEZIUIMIT

Shpenzimet e tjera për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015 dhe ato të mbyllur më 31 Dhjetor 2014 janë të analizuar si më poshtë:

	31 Dhjetor 2015 në Lek	31 Dhjetor 2014 në Lek
Gjoha dhe demshpërblime	7,365,834	14,485,291
	7,365,834	14,485,291

23. TË ARDHURA DHE SHPENZIME TË TJERA FINANCIARE

Të ardhurat dhe shpenzimet financiare janë analizuar si më poshtë:

	31 Dhjetor 2015 në Lek	31 Dhjetor 2014 në Lek
Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme	(5,117)	(23,386,592)
Të ardhura nga interesat dhe të ardhura të ngjashme	39,644,461	-
Humbje nga kembimet valutore	(39,207,431)	-
Fitim nga kembimet valutore	98,890	-
	530,803	(23,386,592)

INTER-GAZ sh.a.

Shënime shoqëruese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015

(Vlerat janë në Lek)

24. TATIMI MBI FITIMIN

Shoqëria është subjekt i tatimit mbi të ardhurat në Shqipëri, norma e të cilit është 15% (2014: 15%). Formularët e deklarimit të tatimit mbi të ardhurat paraqiten çdo vit pranë autoriteteve tatimore, por të ardhurat dhe shpenzimet të deklaruar për qëllime të tatueshme konsiderohen vetë deklarime deri në momentin që janë vëzhguar dhe vlerësuar nga autoritetet tatimore.

Legjislacioni tatimor dhe ligjet Shqiptare janë subjekt interpretimi nga autoritetet tatimore.

	31 Dhjetor 2015 ne Lek	31 Dhjetor 2014 ne Lek
Rezultati i vitit	40,627,573	(8,966,188)
Shpenzime te pazbritshme:		
Gjoha dhe penalitete	7,365,834	14,485,291
Shpenzime te tjera	154,894	
Humbja nga nxjerrja e perdorimit te asetave	1,491,837	
Rezultati tatimor	49,640,138	5,519,103
Tatimi mbi fitimin @ 15%	7,446,021	827,865

25. TRANSAKSIONE ME PALË TË LIDHURA

Gjendjet dhe transaksionet me palët e lidhura për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015 dhe 2014 janë të detajuara si më poshtë:

	31-Dec-15		31-Dec-14	
	Te drejta	Detyrime	Te drejta	Detyrime
Ndaj Ortakeve	1,213,680	564,006,388		528,504,661
Ndaj shoqerive te lidhura	55,040,312	367,745,788	105,970,558	179,077,482
	56,253,537	934,507,839	105,970,558	707,582,143

	31-Dec-15		31-Dec-14	
	Shitje	Blerje	Shitje	Blerje
Ndaj Ortakeve				
Ndaj shoqerive te lidhura	5,624,800	2,834,535	15,900,000	11,846,927
	5,624,800	2,834,535	15,900,000	11,846,927

Balancat dhe transaksionet e mësipërme vijnë nga aktiviteti përditshëm i biznesit dhe janë kryer me kushte tregtare dhe me çmime të përafërta me ato të tregut.

INTER-GAZ sh.a.

Shënime shoqëruese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015

(Vlerat janë në Lek)

26. ANGZHIME DHE PASIGURI

Shoqëria nuk ka ndonjë angazhim në qera operative për vitin e mbyllur 2015.

27. NGJARJE PAS DATËS SË BILANCIT

Shoqëria më 31/03/2016 ka miratimin e planit të riorganizimit sipas procedurave të falimentit nga Gjykata e rrethit Durrës. Ky plan parashikon likuidimin e detyrimeve brenda vitit 2016 dhe kthimin e manaxhimit ndaj organeve të shoqërisë.